

SHTOJCA 2

Model Njoftim Vlerësimi Automatik nga zyra

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE_____

Nr._____Prot

Datë_____

NJOFTIM VLERËSIMI AUTOMATIK NGA ZYRA

Drejtuar: Emri i tatimpaguesit
 Adresa_____
 NUIS/NIPT

I nderuar tatimpagues

Megjithëse jeni njoftuar nga administrata tatimore nëpërmjet “Letër Kujtesës” nr._____, Prot., datë_____ për mosdorëzimin e deklaratës tatimore të _____, për periudhën _____, ju përsëri nuk keni përmbushur detyrimin tuaj për të dorëzuar këtë deklaratë tatimore. Bazuar në nenin 71/1 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ju dërgojmë njoftimin e vlerësimit tatimor, ku detyrimet tuaja janë të llogaritura në mënyrë automatike nga sistemi informatik në përputhje me metodat e parashikuara nga neni 72 i ligjit të sipërcituar.

Sa më sipër ju njoftojmë se detyrimet tuaja tatimore për _____, për periudhën _____ të mosdeklarimit janë:

| Lloji i tatimit | Detyrimi |
|---|----------|
| Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) | |
| Tatim fitimi | |
| Tatim mbi të ardhurat personale nga pagat (TAP) | |
| Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore | |
| Tatim të thjeshtuar mbi fitimin | |
| Tatim në burim i të ardhurave | |
| Taksa kombëtare | |
| Tarifa kombëtare | |
| Taksë për rentën minerare | |

| | |
|----------------------------------|--|
| Tatim mbi lojërat e fatit | |
| Të tjera | |

Ju njoftojmë se, në bazë të paragrafit 4 të nenit 71/1 të ligjit të sipërcituar, ky Njoftim Vlerësimi Tatimor i bërë nga zyra është i paapelueshëm. Vetëm paraqitja e deklaratës tuaj tatimore të kësaj periudhe, me të dhënat reale, e anulon këtë njoftim vlerësimi.

Administrata tatimore, do të fillojë mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore, sipas Njoftim Vlerësimit të bërë nga zyra në mënyrë automatike sipas sistemit informatik, nëse nga ana juaj, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të Njoftim Vlerësimit tatimor nuk është dorëzuar deklarata tatimore ose nuk është paguar shuma e mësipërme e detyrimit.

D R E J T O R I